




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.64/24

Datë: 18.07.2024

Duke u bazuar në nenet, 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës, 18.07.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm, nga Lufthansa Technik AG (aplikuesi) mbi shoqëritë target, LG-LHT Aircraft Solutions GmbH, LG-LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH dhe LG Electronics Inc (shitësi).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenin 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë, 20.05.2024, me Nr. Prot. 311/24-01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga Lufthansa Technik AG (aplikuesi) mbi shoqëritë target LG-LHT Aircraft Solutions GmbH, LG-LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH dhe LG Electronics Inc (shitësi).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë, 19.06.2024
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë, 20.06.2024
3. Palët kanë nënshkruar kontratën mbi shitblerjen e pasurive të paluajjtshme me datë, 4 Prill 2024

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë është 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë më 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e nënshkruar me datë 4 Prill 2019, Lufthansa Technik AG (LHT) dhe LG Electronics Inc. (LGE) krijuan një sipërmarrje të përbashkët (joint-venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët (SP).

Lufthansa Technik AG, është një filiale tërësisht në pronësi të Deutsche Lufthansa AG dhe pjesë e grupit Lufthansa. LHT ofron shërbime globale mirëmbajtje, riparimi dhe çmontimi për mjete fluturuese, si dhe shërbimet e logjistikës, inxhinierisë dhe zhvillimit dhe shërbimet shoqëruese, si dhe shërbimet ndihmese për linjat ajrore dhe operator të tjerë të avionëve.

Lufthansa Technik AG zotërohet 100% nga Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft, shoqëri mëmë e grupit Lufthansa i cili është prezent edhe në Kosovë.

- Degës në Kosovë të Austrian Airlines (NUI: 810492273, me adresë në Lipjan, Prishtina International Airport);
- Degës në Kosovë të Edelweiss Air Sh.A (NUI: 810710360, me adresë në Lipjan, Aeroporti i Prishtinës).

LG Electronics Inc, është një tregtues dhe furnizues mjetesh elektronike, pajisjesh lëvizëse. LGE është një kompani globale me seli në Seul, Koreja e Jugut, aktive në furnizimin e elektronikës, komunikimeve celulare, pajisjeve shtëpiake dhe zgjidhjeve ajrore, si dhe komponentëve të automjeteve.

Shoqëritë Target:

LG-LHT Aircraft Solutions GmbH (SP-A), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti zhvillimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve për linjat ajrore komerciale dhe prodhuesit e pajisjeve origjinale të avionëve komerciale dhe kompani të tjera të përfshira në aviacionin komercial.

LG-LHT Passenger Solution GmbH (SP-P), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, fokusohet në zhvillim, prodhimin, mirëmbajtjen dhe shitjen e produkteve dhe shërbimeve për linjat ajrore komerciale dhe prodhuesit e pajisjeve origjinale të avionëve komerciale dhe kompani të tjera aktive në aviacionin komercial.

Shoqëritë LG-LHT Aircraft Solution GmbH dhe LG-LHT Passenger Solution GmbH aktualisht zotërohen 51% nga Lufthansa Technik AG dhe 49% nga LG Electronics Inc.

AerQ GmbH (SP-S), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit gjerman, fokusohet kryesisht tek shitjet, marketingu dhe shërbimet e nivelit të parë për klientët për produktet dhe shërbimet për linjat ajrore komerciale dhe prodhuesit e pajisjeve origjinale të avionëve komercialë dhe kompani të tjera aktive në aviacionin komercialë.

Struktura e Përqendrimit

Me datë 20.04.2024, shoqëritë Lufthansa Technik AG dhe LG Electronics Inc., nënshkruan Amendamentin e dytë të Marrëveshjes për Sipërmarrje të Përbashkët dhe Marrëveshje të Investimit.

Aktualisht LHT zotëron 51% dhe LGE zotëron 49% të kapitalit në secilën prej SP-ve. LHT do të rris fillimisht pjesëmarrjen e saj në kapitalin e SP-ve të Nivelit të Sipërm, nga niveli aktual prej 51% në 63.54%, ndërkohe që pjesëmarrja e LG Electronics Inc, në kapitalin e këtyre shoqërive do të zvogëlohet, nga niveli aktual prej 49% në 36.46%.

Në një raund të dytë, Lufthansa Technik AG mundet me diskrecionin e saj, të rrisë pjesëmarrjen në SP-të e Nivelit të Sipërm, deri në nivelin maksimal prej 70% me një zvogëlim korrespondues të pjesëmarrjes së LG Electronics Inc, deri në 30%.

Përtej parashikimit të kushteve të investimit nga LHT, mbi këtë bazë, sipas Marrëveshjes së Investimit (MI-së), palët ritheksojnë marrëveshjen e Sipërmarrjes së Përbashkët, duke përcaktuar kushtet që rregullojnë marrëdhëniet e tyre të ardhshme si ortakë të SP-ve. Duke i dhënë Lufthansa Technik AG kontrollin e vetëm mbi Sipërmarrjen e Përbashkët, ku të drejtat e LG Electronics Inc dhe ndaj Sipërmarrjes së Përbashkët janë të kufizuara në të drejta ligjore të një ortaku pakicë në një shoqëri të së drejtës gjermane me përgjegjësi të kufizuara, ii) duke lejuar konsolidimin financiarë të Sipërmarrjeve të Përbashkëta tek Lufthansa Technik AG dhe duke hequr dorë nga çdo dispozitë e Marrëveshjes së Sipërmarrjes së Përbashkët, që i jep LG Electronics Inc. Të drejtën për të fituar kontroll mbi ndonjërin nga SP-të.

Transaksioni i propozuar, është një përfitim i drejtpërdrejtë kontrolli me baza të qëndrueshme nga LHT mbi tërësinë e SP-ve të Nivelit të Sipërm dhe indirekt i tërësisë së SP-ve.

Me marrëveshjen e Aksionarëve, si dhe në statusin e shoqërive SP-A dhe SP-P, parashikohen se vendimet e ortakëve miratohen me shumicë të thjeshtë të votave të shprehura, përveç rastet kur ligji i detyrueshëm ose statusi i shoqërisë parashikon një shumicë të ndryshme.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit, do të konsiderohet treg i ofrimit të shërbimeve dhe produkteve lidhur me projektimin, zhvillimin dhe furnizimin e sistemeve të menaxhimit të kabinës dhe të sistemeve të argëtimit në fluturim për avionët tregtar. Duke qenë se Transaksioni i propozuar, prekë një treg që nuk është i zhvilluar në Kosovë, është marrë në konsideratë edhe praktika e Komisionit Evropian, në çështje të ngjashme tregu përkatës mund të lihet i hapur.

Tregu gjeografik, në transaksionin e propozuar përkufizohet si treg me shtrirje në nivel botëror.

Analiza e konkurrencës

Transaksioni i propozuar, konsiston në përfitimin e kontrollit të vetëm të shoqërive LG-LHT Aircraft Solutions GmbH, LG-LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH nga shoqëria Lufthansa Technik AG. Lufthansa Technik AG zotërohet 100% nga Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft, shoqëri mëmë e grupit Lufthansa i cili është prezent në tregun e Republikës së Kosovës.

Transaksioni i propozuar nuk do të shkaktojë, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës efektive në tregun kosovar dhe rrjedhimisht nuk do të shkaktojë ndryshim në strukturën aktuale të ndërmartjeve, që janë prezentë në Kosovë. Rrjedhimisht transaksioni i propozuar nuk rezulton, në një pakësim ose parandalim të konsiderueshëm të konkurrencës. Gjithashtu transaksioni i propozuar pritet të ketë efekte marginale ose të mos ketë aspak efekte në tregun kosovar.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar, nuk do të realizohet në territorin e Republikës së Kosovës. Shoqëritë të cilat janë target i Njoftimit për Përqendrim, nuk janë aktive në Kosovë dhe nuk gjenerojnë të ardhura. Transaksioni i njoftuar, nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun e Republikës së Kosovës.

Nga analiza e cekur më lartë, rezulton se transaksioni i propozuar, nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë dhe se është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, konstaton se përqendrimi i njoftuar, bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga vlerësimi i “Njoftimit”, i njëjti nuk do të paraqet efekte negative për konkurrencën, rrjedhimisht, nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi, menjëherë.


**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar



Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva